



AGENDA 2020

Piraeus Bank's Strategic Plan

GRUPI PIRAEUS BANK SHPALL PLANIN E TIJ STRATEGJIK 2020: "AXHENDA 2020"

Sot Piraeus Bank, nën drejtimin e lidershipit të ri, shpall qëllimin për të marrë një hap vendimtar përpara "për të qenë banka më e besuar në Greqi, për të krijuar vlerë për aksionerët, klientët dhe punonjësit e saj," duke shpallur planin strategjik për vitin 2020, "**Axhenda 2020**".

"**Axhenda 2020**" ka për qëllim të përcaktojë prioritete të qarta strategjike në nivel afatmesëm që do të forcojnë besimin e aksionerëve mbi të ardhmen e Piraeus Bank, dhe do të zëvendësojë madje edhe tejkalojë, çdo angazhim të marrë më parë.

"**Axhenda 2020**" bazohet në objektivat dhe qëllimet kyç si më poshtë:

- **uljen e Kredive me Probleme drejt një niveli të normalizuar;**
- krijimin e një **modeli biznesi fitimprurës dhe të qëndrueshëm**, me kthyeshmëri tërheqëse për aksionerët në terma afatmesëm;
- mbajtjen e një **baze të fortë të kapitalit;**
- rivendosjen e aksesit të financimit në tregun me shumicë.

"**Axhenda 2020**" përbëhet nga gjashtë drejtime specifike të strategjisë:

1. **Zhveshja nga rreziku e Bilancit**, për t'u arritur duke ndarë Grupin në dy shtylla operimi për të maksimizuar vlerën nga biznesi bazë i Grupit tonë, dhe duke u fokusuar në realizimin e vlerës nga posedimet e mbetura. Me anë të kësaj ndarje, Piraeus Bank ka për synim rregullimin e operacioneve të saj dhe forcimin e aftësisë për gjenerim organik të kapitalit. Publikimet e Bankës për investitorët në të ardhmen do të konsiderojnë edhe këtë ndarje.

Dy shtyllat janë:

- a. **Piraeus Bank**, që do të fokusohet në avantazhet konkurruese të biznesit të tij bazë në tregun lokal, me asete të ponderuara me rrezik aktualisht në masën 28.4mln €. Do të fokusohet në financimin e huamarrësve të shëndetshëm, duke patur si synim gjithashtu të ruajë pozicionin e tij lider në depozitat e klientëve. Piraeus do të mbetet një bankë e fokusuar në klientët SME dhe korporata, shoqëruar me një rritje të produkteve të kredisë për tregun me pakicë (retail) gjeneruar nën metodën e rregullimit me nivelin e rrezikut.



- b. **Piraeus Legacy Unit (PLU)**, përbërë nga asete jo-bazë që përfshijnë gjithashtu biznese tërheqëse në terma afatgjatë, me një pozicion të fortë në treg që, sidoqoftë, nuk arrijnë profilin e kthyeshmërisë së synuar nga Grupi. Një skuadër e dedikuar administruese do të kërkojë të maksimizojë vlerën duke realizuar shitje që gjenerojnë vlerë, apo duke kërkuar mundësi të tjera transformuese. Këto biznese dhe asetet e tyre do të përfshijnë si fillim kreditë e Njesisë së Rekuperimit të Kredive me Probleme, aksione në asete të tjera lokale jo bazë, pronat e paluajtshme të poseduara dhe operacione ndërkombëtare që përfshihen në Planin e Ristrukturimit të Bankës. Asetet totale të ponderuara me rrezik të kësaj njësie kanë aktualisht vlerën e 24.7 mld €.

Deri në fund të vitit 2020, pritet që asetet totale të Grupit të ulen në afro 70mld €, me një kontribut me rreth 80 % të aseteve të Bankës Piraeus (bazë) ndaj afro 65 % që janë aktualisht. Kreditë e administruara nga PLU do të ulen nga 37 mld € aktualisht në një nivel më pak se 20 mld €, ndërsa RWA (asetet e ponderuara me rrezik) të PLU do të përgjysmohen nga niveli aktual i rreth 25mld €. Norma e kostos ndaj të ardhurave të Grupit do të përmirësohet në nivel rreth të dyzet e pesë përqind, ndërsa kthyeshmëria e aseteve të Grupit (RoA) do të rritet në nivele mbi 1%.

2. **Riformatim dhe fokus** nëpërmjet rishikimit të disiplinuar të gjithë bizneseve ekzistuese, me qëllim maksimizimin e burimeve në zonat ku Piraeus ka pozicion zotërues historik. Kjo do të përfshijë një strukturë më të thjeshtësuar të Grupit dhe masa efektive të racionalizimit të kostove, sikurse edhe optimizim të mëtejshëm të rrjetit tonë të degëve si dhe investime të synuara drejt dixhitalizimit.
3. **Implementimi i një Modeli Biznesi Fitimprurës dhe të Qendrushëm**, duke zhvilluar marrëdhëniet me klientin tashmë mjaft të vlerësuar, duke u fokusuar në rritjen e mundësive për shitje të kryqëzuara, sikurse edhe aktivitetet që gjenerojnë komisione. Piraeus Bank ka për synim të vazhdojë të zhvillojë produkte inovative, marketing drejt segmenteve të synuara të klientëve përmes strategjive të shpërndarjes shumë-kanalëshe, duke vënë në zbatim një politikë kreditimi të synuar dhe të bazuar tek administrimi i rrezikut, si dhe duke implementuar metodologji të avancuara të përlllogaritjes së cmimit bazuar në rrezikun e vlerësuar, me qëllim që të sigurojë kthyeshmëri të qëndrueshme dhe tërheqëse të operacioneve të saj bazë.
4. **Optimizimi i Alokimit të Kapitalit** përmes implementimit të një sistemi për vlerësimin e rrezikut të pranuar, që përfshin një qasje të alokimit të kapitalit në bazë të tipologjisë së portofolit. Piraeus planifikon të ruajë bilanc të mirëkapitalizuar, të aftë t'i rezistojë goditjeve të paprituara të jashtme, dhe në të njëjtën kohë të sjellë kthyeshmëri më të lartë t'për aksionerët.





5. **Forcimi i Monitorimit të Rrezikut dhe Kontrolleve.** Ne i japim një rëndësi të veçantë monitorimit efektiv dhe menaxhimit të rrezikut, me një vizion për të siguruar stabilitetin dhe vazhdimësinë e operacioneve tona. Piraeus do të forcojë më tej funksionet e tij të mbështetjes dhe kontrollit (Audit, Përputhshmëri, Administrim i Rrezikut të Kredisë, Financë, Ligjor dhe Administrimi i Rrezikut Operacional), në përputhje me tre linjat e mbrojtjes.
6. **Zbatimi i Standarteve më të mira të Qeverisjes.** Piraeus Bank ka vënë tashmë në zbatim kërkesat specifike të ligjit HFSF, ka rishikuar kërkesat e Planit të Ristrukturimit lidhur me qeverisjen e korporatës. Banka ka përfunduar tashmë rikompozimin e Bordit të Drejtorëve, duke siguruar mbledhje të vazhdueshme të Bordit dhe Komiteteve. Piraeus ka tashmë një Bord Drejtorësh me anëtarë të mirënjohur ndërkombëtarë , që sjellin eksperiencë domethënëse dhe të larmishme në banking, administrimin e rrezikut dhe në administrimin e kredive me probleme.

“Axeenda 2020” vendos një set të qartë prioritetesh strategjike, që me zbatim të fokusuar dhe efektiv, do të sigurojnë rrugën e duhur drejt rekuperimit të plotë të Piraeus Bank.

Athinë, 24 maj 2017

